




**Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës**



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 20

Datë: 02-06- 2021.

KONTRATË PROKURIMI Nr.11

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

AFRIM R.MAZREKU B.I (D.P.SH."TE HAMZA") me seli në Malishevë me Nr.biznesi 811152800 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për :

LARJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE

me numër identifikues: **62500-21-2844-2-3-6/62500-21-041-236**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **LARJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe përfundon me kryerjen e Larjes së automjeteve zyrtare.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [shëno numrin] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: **Në Qytetin e Malishevës.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).**

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3. **ÇMIMI**

3.1 Çmimi total i kontratës është : **4,706,40€** (me shkronja) :

(katërmijëeshtatëqindëegjashtëeuroekatërdhjetëcentë)Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 3.3. **Menaxhimi i Kontratës**

Menaxhimin e Kontratës Larja e automjeteve zyrtare do ta bëjë zyrtari i administratës **z.Besim Begaj** i caktuar nga ZKA i AK-së.

Neni 3.4. **Obligimet e OE**

OE është i obliguar që Larjen e automjeteve zyrtare ta kryej në përputhëshmëri të plotë me specifikacionin e ofertës. Larja e automjeteve zyrtare duhet të kryhet në cilësi të kërkuar nga AK. Nëse Larja e automjeteve zyrtare nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhëshmëri me specifikacionin e ofertes shpenzimet e bëra biejnë në llogari të operatorit ekonomik. OE nuk do të i pranohen edhe shërbimet e kryera pa porosi të AK. Kontraktuesi i parë (AK) e ruan të drejtën që t'a ndërprej kontratën me kontraktuesin e dytë (OE) për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe afatë .

Neni 3.5. **AFATI**

Larja e automjeteve zyrtare do të kryhet në periudhën prej 12 muajsh që nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Neni 4. **PAGESA**

4.1. Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2. Obligohet kontraktuesi i parë (AK) që pasi t'a pranon raportin e kryerjes së shërbimit nga zyrtari përkatës dhe faturën nga kontraktuesi i dytë (OE) t'ia paguaj shumën sipas neni. 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate (pagesa kontraktuesit të dytë do të i bëhet në bazë të raportit të zyrtarit të caktuar nga ZKA i AK për menaxhim të kontratës).

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5. **Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6. **Kualiteti**

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7. **Garancioni**

7.1. Garancioni do të mbetet valid për _____ muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8. **Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryej ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa realizuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9. **Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10. **Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11. **Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton

interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12. **Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13. **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14. **Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Afrim Mazreku
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	02.06/2021	Data:	02.06.2021
Vula:		Vula:	



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



SPECIFIKACIONI PËR LARJEN E VETURAVE ZYRTARE DHE KAMIONËVE TË SHERBIMIT TË ZJARRËFIKSËVE

Nr	EMËRTIMI I POZICIONEVE	Njësia matëse	Sasia	Numri i larjeve	Çmimi për një larje	Totali me TVSH
1	Pastrimi i 29 automjeteve mbrenda dhe jashtë. Një automjetet do të pastrohet 48 herë në vitë sipas nevojës (per çdo muaj nga 4 pastrime per nje automjet), gjithsejtë 1392 pastrime.	Automjet	29	1392	2.95	4,106.40
2	Pastrimi i kamionëve të SHZSH-së mbrenda dhe jashtë. Kamionët do të pastrohen 12 herë në vitë sipas nevojës (per çdo muaj nga 1 larje per kamion) gjithesejtë 60 pastrime.	Kamion	5	60	10	600.00
TOTALI:						4,706.40€

